

Në datat 2-4 Mars 2018 u zhvillua në LUXEXPO Luksemburg Festivali i 35^{të} i Imigracionit, Qytetërimeve dhe Kulturave që organizohet nga CLAE (Komiteti Ndërlidhës për Shoqatat e të Huajve në Luksemburg), dhe ka për qëllim prezantimin e kulturës/traditave të komuniteteve që janë prezente në Luksemburg.



Komuniteti shqiptar u përfaqësua në këtë aktivitet me një stendë të përgatitur me ushqime tradicionale, pije si dhe punime artistike nga vendi jone. Vlen të theksojmë së ushqimet e prezantuara u përgatiten nga vetë përfaqësuesit e komunitetit pjesëmarrës, që ishin jo vetem nga Shqipëria, por edhe nga Kosova si dhe shqiptarët e Maqedonisë, të cilët u paraqiten të veshur me kostume popullore nga viset shqiptare.



Stenda e komunitetit shqiptar u frekuentua nga një numër i konsiderueshëm vizitorësh, to cilët shprehën mbresat dhe përshtypjet më të mira për ushqimet tradicionale të prezantuara në këtë stendë.



Në këtë festival mori pjesë edhe Shoqata Vena Arbëreshe nga Kalabria, të cilët prezantuan veshjet tradicionale, prodhime ushqimore karakteristike si dhe shfaqën një koncert me kenge arbëreshe.

Me mbështetjen e Ambasadës së RSh në stendë u prezantuan edhe fletë palosje, broshura, mbi atraksionet turistike të vendit tonë.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet është një mundësi e mirë për prezantimin e kulturës/traditave të vendit tonë për publikun luksemburgez.